

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
SOUTH-EAST EUROPEAN UNIVERSITY
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА



FAKULTETI I BIZNESIT DHE EKONOMISË
FACULTY OF BUSINESS AND ECONOMY
ФАКУЛТЕТ ЗА БИЗНИС И ЕКОНОМИЈА

STUDIME POSTDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË

TEZA:

NDIKIMI I KONKURRENCËS MBI RRITJEN EKONOMIKE
NË SHTETET E EVROPËS JUGLINDORE

KANDIDATI:

Arta Limani

MENTORI:

Prof. dr. Shenaj Haxhimustafa

Tetovë, 2020

Mirënjohje dhe falënderim

Dua të shpreh mirënjohje të thellë ndaj mentores sime doc. dr. Shenaj Haxhimustafa e cila me eksperiencën e saj akademike më mundësoi që unë të marrë njohuri në lidhje me këtë hulumtim. Ajo, e vështroi temën time me profesionalizëm dhe më dha rekomandime të ndryshme dhe qenësore. Me ndihmën e saj, unë arrita deri në finalizimin e punimit, shpresoj që me njohuritë të cilët i kam fituar të arrij suksese të mëdha në të ardhmen dhe të më ndihmojnë për t'u bërë profesioniste edhe më e mirë në fushën e ekonomisë.

Falënderime të sinqerta iu drejtohen edhe anëtarëve të komisionit, doc. dr. Gadaf Rexhepi dhe doc. dr. Agron Caushi, për bashkëpunimin dhe durimin që treguan përgjatë periudhës së realizimit të këtij hulumtimi.

Falënderoj thellësisht dhe u jam mirënjohëse dy personave të veçantë, nënës sime znj. Radife Iljazi dhe babait tim z. Gylnehar Iljazi të cilët më dhanë mbështetje të pakusht për realizimin e këtij punimi. Po ashtu falënderoj edhe familjen time të gjerë dhe shoqërinë të cilët në mënyra të ndryshme e lehtësuan punën time.

PËRMBAJTJA

Mirënjohje dhe falënderim.....	2
Abstrakt.....	5
Апстракт	6
Abstract.....	7
1.HYRJJE	8
2.SHQYRTIMI I LITERATURËS	11
3.KONKURENCA GLOBALE.....	15
1.1Konkurrenca globale ne fushën e kërkesave themelore	17
2.2Konkurrenca globale në fushën e përmirësuesve të efikasitetit	18
2.3 Konkurrenca globale në fushën e inovacionit dhe faktorëve të sofistikimit.....	20
2.4 Krahasim i konkurrencës Globale mes shteteve BE dhe jo-BE.....	21
3.Analiza e shtyllave te Indeksit Global të Konkurrencës në Evropën Juglindore.....	22
3.1 Analiza Indeksit Global të Konkurrencës në Bosnjë dhe Hercegovinë	22
3.2 Analiza e Indeksit Global të Konkurrencës në Bullgari.....	24
3.3 Analiza e Indeksit Global të Konkurrencës në Greqi.....	26
3.4 Analiza e Indeksit Global të Konkurrencës në Kroaci.....	28
3.5 Analiza e Indeksit Global të Konkurrencës në Mal të Zi.....	30
3.6 Analiza e Indeksit Global të Konkurrencës në Maqedonisë Veriore	32
3.7 Analiza e Indeksit Global të Konkurrencës në Romani	34
3.8 Analiza e Indeksit Global të Konkurrencës në Sërbi	36
3.9 Analiza e Indeksit Global të Konkurrencës në Slloveni	38
3.10 Analiza e Indeksit Global të Konkurrencës në Shqipëri	40
4.KONKURENCA GLOBALE DHE RRITJA EKONOMIKE.....	42
5.METODOLOGJIA	43

4.4. Modelet Fixed dhe Random Effect	44
6. KOMENTIMI I REZUKTATEVE	48
5. PËRFUNDIMI	50
6. LITERATURA E SHFRYTËZUAR	52
7. LLOGARITJET NË APPENDIX	57

Abstrakt

Në këtë punim do të hulumtojmë konkurrencën e vendeve të Evropës Juglindore si nxitës të rritjes ekonomike. Hulumtimi do të kryhet për vendet si Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Greqia, Kroacia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Romania, Serbia, Sllovenia dhe Shqipëria. Do të analizojmë nëse Indeksi Global i Konkurrencës i Forumit Ekonomik Botëror (WEF) ndikon në rritjen ekonomike e matur me PBB-në për frymë banori. Po ashtu do të shqyrtohen problemet e konkurrencës në vendet e Evropës Juglindore, me theks të veçantë pozita e këtyre vendeve sipas Forumit Ekonomik Botëror duke i ndarë në dy grupe: shtetet që janë anëtare të Unionit Evropian dhe ato që nuk janë. Teza analizon 12 shtyllat e konkurrencës sipas Indeksit Global të Konkurrencës, faktorë të cilët sqarojnë se sa një vend është konkurrent dhe lidhjen e tyre me rritjen ekonomike.

Përmes këtij punimi do të synojmë të ofrojmë një studim real të detajuar në lidhje me konkurrencën dhe rritjen ekonomike të këtyre vendeve, me qëllim që t'ju ndihmojmë politik bërësve dhe menaxherëve.

Fjalët kyçe: *konkurrenca, rritja ekonomike, Evropa Juglindore, Indeksi Global i Konkurrencës.*

Апстракт

Во овој труд ќе ја истражуваме конкурентноста во земјите од Југоисточна Европа како двигатели на економскиот раст. Истражувањето ќе биде спроведено за земји како Босна и Херцеговина, Бугарија, Грција, Хрватска, Црна Гора, Северна Македонија, Романија, Србија, Словенија и Албанија. Ќе анализираме дали Глобалниот Индекс за Конкурентност од Светскиот Економски Форум (СЕФ) има влијание врз економскиот раст мерен преку БДП по глава. Исто така ќе биде истражено дали проблемите со конкурентноста во земјите од Југоисточна Европа, и посебно внимание ќе биде посветено на позицијата на овие земји според Светскиот Економски Форум, поделувајќи ги земјите на две групи: земјите кои се членки на Европската Унија и тие кои не се членки. Тезата ги анализира 12те столба на конкурентноста според глобалниот индекс за конкурентност, фактори кои објаснуваат колку конкурентна е одредена земја и нивната поврзаност со економскиот раст.

Целиме да овој труд претстави детално истражување на конкурентноста и економскиот раст во овие земји, со цел да им се помогне на тие кои ги подготвуваат политиките и на менаџерите.

Клучни зборови: *Конкурентност, Економски Раст, Југоисточна Европа, Глобален Индекс на Конкурентност.*

Abstract

In this paper we will explore the competitiveness of Southeast European countries as drivers of economic growth. The survey will be conducted in countries such as Bosnia and Herzegovina, Bulgaria, Greece, Croatia, Montenegro, Northern Macedonia, Romania, Serbia, Slovenia and Albania. We will analyze if the Global Competitiveness Index of World Economic Forum (WEF) affects economic growth measured by GDP per capita. We will also examine competition problems in the countries of Southeast Europe according to the World Economic Forum, dividing them into two groups: countries that are members of the European Union and those that are not. The thesis analyzes the 12 pillars of competition according to the Global Competitiveness Index, factors which explain how competitive a country is and their relationship with economic growth.

Through this paper we will aim to provide a real detailed study on the competitiveness and economic growth of these countries, in order to help policy makers and managers.

Keywords: *Competition, Economic Growth, Southeast Europe, Global Competitiveness Index*

1.HYRJJE

Ekziston një debat i vazhdueshëm mes politikanëve dhe studiuesve në lidhje me kuptimin dhe komponentët e konceptit të konkurrencës. Porter argumenton se i vetmi koncept kuptimplotë i konkurrencës është produktiviteti kombëtar (Porter, 1998). Ai propozoi një model kombëtar "diamante", i cili identifikon katër klasa të attributeve të vendit që përcaktojnë përparësinë konkurruese kombëtare: strategjia e firmës, pra struktura dhe rivaliteti, kushtet e faktorëve, faktori i kërkesës dhe industritë e ngjashme dhe mbështetëse. Ai gjithashtu tregon dy faktorë të tjerë - politikat qeveritare dhe shanset (goditjet ekzogjene) - që mbështesin sistemin e konkurrencës kombëtare por nuk e krijojnë atë (Porter, 1990). Berger identifikon katër konstruksione teorike kryesore, por shumë të ndryshme për konkurrencën kombëtare të cilat tregojnë divergjenca të mëdha. Konkurrenca kombëtare mund të kuptohet si "aftësia e një kombi për t'i shitur mallrat e tij në tregun e vendit apo në një komb tjetër", si "aftësia e një kombi për të fituar: produktiviteti dhe orientimi i performancës ", si "aftësia për t'u përshtatur me ndryshimet në mjedisin e jashtëm" dhe si "aftësinë për të tërhequr burime" (Berger, 2008). Çdo qasje nënkupton përdorimin e indikatorëve të ndryshëm për të vlerësuar konkurrueshmërinë e vendit. Indeksi Global i Konkurrencës i Forumit Ekonomik Botëror (WEF), i cili është referuar gjerësisht si një instrument i besueshëm metrikë i konkurrencës kombëtare, e cila bazohet në përkufizimin e Porter tregon që konkurrenca e një vendi është një grup faktorësh makroekonomikë dhe mikroekonomikë që përcaktojnë respektivisht produktivitetin dhe rritjen ekonomike (WEF).

Rritja ekonomike është një rritje në prodhimin e mallrave dhe shërbimeve gjatë një periudhe të caktuar. Produkti i brendshëm bruto është mënyra më e mirë për të matur rritjen ekonomike. Ai merr parasysh të gjithë prodhimin ekonomik të vendit. Ai përfshin të gjitha mallrat dhe shërbimet që bizneset në vend prodhojnë për shitje. Nuk ka rëndësi nëse ato shiten në vend apo jashtë saj.¹

➤ ¹ <https://www.thebalance.com/>

Në këtë punim do të analizojmë marrëdhëniet midis konkurrencës e cila përcaktohet nga Forumi Ekonomik Botëror dhe rritjes ekonomike, të matur nga prodhimi i brendshëm bruto (PBB) për normat e rritjes për frymë. Studimet ekzistuese mbi marrëdhëniet midis konkurrencës dhe rritjes ekonomike janë përqendruar kryesisht në shtylla të caktuara të konkurrencës (Kostoska Olivera, Hristoski Ilija 2017), diskutojnë konkurrencën në një vit të caktuar (Komisioni Evropian, 2014), ose vlerësojnë konkurrueshmërinë për vendet e përzgjedhura të Evropës Juglindore (Polonna Tominc, Romana Korez Vide, 2016,Olipmia Neag, 2018). Nuk ka një pasqyrë gjithëpërfshirëse në progresin dhe regresionin e të gjitha dimensioneve të konkurrencës në një periudhë më të gjatë dhe ndikimet e tyre të mundshme në normat e rritjes ekonomike të këtyre shteteve. Analiza jonë është bërë në një mostër të shteteve të Evropës Juglindore më konkretisht te shtetet si: Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Greqia, Kroacia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Romania, Serbia, Sllovenia dhe Shqipëria që kishin një trashëgimi të ngjashme politike dhe kështu edhe mundësi të krahasueshme të zhvillimit ekonomik.

Në këtë punim shkencor është aplikuar metoda “ Panel Data”, më konkretisht “Fixed Effects”, “Random Effects” dhe “Hausman Taylor”, për të testuar lidhjen ndërmjet indeksit global të konkurrencës dhe rritjes ekonomike në periudhën 2007-2017. Me anë të këtyre metodave dhe modeleve që janë potencuar më lartë do të mbështeten konstatimet në lidhje me relacionet e këtyre variablave. Qëllimi kryesorë në këtë punim është konfirmimi ose hedhja poshtë e këtyre hipotezave :

H1/1:Rritja e Indeksit Global të Konkurrencës ka ndikim pozitiv në rritjen ekonomike në shtetet e Evropës Juglindore

H2/2:Ndikimi i konkurrencës në rritjen ekonomike është më e lartë në shtetet e Evropës Juglindore të cilat janë pjesë e Unionit Evropian

Pas hyrjes dhe hipotezave të cilat janë parashtruar në hulumtim, është bërë rishqyrtimi i literaturës ku do të përfshijë mendime dhe konkluzione të ndryshme të autorëve në lidhje me

konkurrencën dhe rritjen ekonomike, analizë për konkurrencën globale në shtetet e Evropës Juglindore, situatat momentale dhe përmirësimi apo përkeqësimi për periudhën 2007-2017, më tej analizohen në mënyrë më të detajuar shtyllat e indeksit global të konkurrencës edhe atë: analizimi i konkurrencës globale në fushën e kërkesave themelore, në fushën e përmirësuesve të efikasitetit si dhe në faktorët e inovacionit dhe sofistikimit të biznesit, pas saj në formë të veçuar është analizuar konkurueshmëria e çdo shteti të marë në hulumtim, metodologjia hulumtuese, interpretimi i rezultateve dhe përfundimi.

2.SHQYRTIMI I LITERATURËS

Sipas Forumit Ekonomik Botëror, konkurrenca e një vendi është një grup prej 12 shtyllave, të strukturuar në tre grupe:

Grupi i parë lidhet me kërkesat themelore të cilat janë: institucionet, infrastruktura, stabilitetit makroekonomik, shëndetësia dhe arsimit fillor.

Grupi i dytë përfaqëson përmirësuesit e efikasitetit, edhe atë: arsimit të lartë dhe trajnimet, efikasiteti i tregut të mallrave, efikasiteti i tregut të punës, zhvillimi i tregut financiar, përgatitja teknologjike dhe madhësia e tregut.

Grupi i tretë përfshin faktorët e inovacionit dhe sofistikimit, edhe atë: inovacioni dhe faktorët e sofistikimit të biznesit.

Të 12 shtyllat tentojnë të përforcojnë njëra-tjetrën dhe një dobësi në një fushë shpesh ka një ndikim negativ në të tjerët (WEF 2014). Për secilën nga 12 shtyllat e konkurrencës së një vendi, ekzistojnë dëshmi empirike për ndikimin e tyre në rritjen ekonomike.

Cilësia e institucioneve paraqet një nga faktorët kyç në rritjen ekonomike, ajo përcaktohet nga kuadri ligjor dhe administrativ brenda të cilit individët, firmat dhe qeveritë ndërveprojnë për gjenerimin e pasurisë (Acemoglu et al.2002 North, 1989; Rodrik et al, 2002). Institucionet publike mund të imponojnë kosto të konsiderueshme ekonomike për bizneset dhe të ngadalësojnë procesin e zhvillimit ekonomik p.sh. burokracia e tepruar, mbivlerësimi, korrupsioni, pandershmeria në trajtimin e kontratave publike, mungesa e transparencës, pamundësia për të ofruar shërbime të përshtatshme për sektorin e biznesit, menaxhimi jo i duhur i financave publike dhe varësia politike e sistemit gjyqësor (Miller et al, 2014). Vlen të theksohet që siguria e të drejtave pronësore stimulon rritjen ekonomike (Vijayaraghavan, Maya, Eard, Eilliam A. 2001). Pos kësaj, nëse kuptohen mirë përcaktuesit e ekuilibrit politik, atëherë mund të dizajnohen ndërhyrje të cilat shoqëritë e varfra i bëjnë të pasura (Daron Acemoglu James Robinson 2008).

Cilësia dhe gjerësia e rrjeteve të infrastrukturës integrojnë tregun kombëtar dhe e lidhin atë me shpenzime të ulta në tregjet e vendeve të tjera, nga çka bëhet e mundur marrja e mallrave dhe shërbimeve në treg në mënyrë më të sigurtë dhe në kohë, lejohet një rrjedhje e shpejtë dhe e

lirë e informacionit, përcaktojnë vendndodhjen e aktiviteteve ekonomike, lehtësojnë lëvizjen e punëtorëve, parandalojnë ndërprerjet dhe mungesat e furnizimeve të energjisë etj. Ndikimi i tyre në rritjen ekonomike është identifikuar nga shumë punime (Canning dhe Pedroni, 1999, Calderon dhe Serven, 2004, Satyananda Sahoo, 2000, Balazs Egert, Tomasz Kozluk and Douglas Sutherland, 2009).

Konfliktet midis grupeve të ndryshme brenda një vendi dhe ekzistimi i institucioneve të dobëta për menaxhimin e konflikteve e pamundëson zbatimin e nevojshëm të rregullave makroekonomike ndaj goditjeve të jashtme, e cila në afat të gjatë dëmton rritjen ekonomike (Dani Rodrik 1999). Ndryshueshmëria në ofertën e parasë ndikon negativisht te rritja ekonomike (Robert Barro 1980), po ashtu egziston një korrelacion negativ midis normave të inflacionit, deficitit buxhetor të qeverisë dhe mbivlerësimit të parasë me rritjen ekonomike (Fischer 1993)

Theks të veçantë ka edhe shëndetësia në rritjen ekonomike, punonjës të shëndosh dhe popullata e shëndoshe ndikojnë pozitivisht në rritjen ekonomike, për këtë arsye është i nevojshëm investimi në shërbime shëndetësore që të kemi zhvillim më të mirë ekonomik (Sachs, 2001).

Arsimi paraqet rol kyç në zhvillimin e një vendi. Shtetet me popullatë të arsimuar kanë dukshëm zhvillim më të madh ekonomik. Shoqëria e arsimuar ka korrelacion pozitiv me rritjen ekonomike dhe aftësinë e qeverive për të ndihmuar luftën ndaj varfërisë.(Mankië, Romer dhe Ëeil ,1992, Barro (1991), Hanushek (1995), Temple (2001), Krueger dhe Lindahl (2001))

Vendet me treg mallrash efikase prodhojnë përzierjen e duhur të produkteve dhe shërbimeve sipas kushteve të veçanta të tyre për furnizim. Ata gjithashtu sigurojnë që këto mallra të mund të tregtohen në mënyrë më efikase në ekonomi(WEF 2014). Mjedisi më i mirë i mundshëm për shkëmbimin e mallrave kërkon një nivel të lartë të konkurrencës së tregut dhe një minimum të ndërhyrjes së qeverisë që pengon aktivitetin e biznesit (Branstetter et al, 2010). Hapja ndaj konkurrencës ndërkombëtare nëpërmjet tregtisë dhe investimeve i mundëson një vendi të përmirësojë produktivitetin, të zgjerojë industritë lokale më produktive dhe të ketë qasje në teknologji dhe njohuri më të avancuara nga jashtë (Delgado et al, 2012). Një marrëdhënie pozitive ndërmjet hapjes dhe prosperitetit është gjetur nga disa hulumtues (Alesina et al, 2005, Baldëin, 2003, Dollar dhe Kraay, 2003), po ashtu është identifikuar edhe ndikimi pozitiv i

tregtisë në transferimin e njohurive dhe inovacionit të fortë në një vend (Branstetter, 2006). Efikasiteti i tregut varet gjithashtu nga kushtet e kërkesës, siç janë orientimi i konsumatorëve dhe sofistikimi i blerësit (Porter, 1998). Konsumatorët më kërkues detyrojnë kompanitë të jenë më inovativë dhe të orientuar drejt konsumatorëve dhe kështu të imponojnë disiplinën e nevojshme për efikasitetin e tregut.

Për të arritur efikasitetin e tregut të punës, punëtorët duhet të alokohen për përdorimin e tyre më efektiv në ekonomi dhe të ofrojnë stimuj për të investuar përpjekjet e tyre më të mira në vendet e tyre të punës. Kështu, tregu i punës mbështet rritjen ekonomike nëse është mjaft fleksibël për të zhvendosur punëtorët nga një aktivitet ekonomik në një tjetër me shpejtësi dhe me kosto të ulët dhe lejon luhatjet e pagave pa shumë përçarje sociale (Kaplan, 2009). Ekziston një lidhje pozitive mes efikasitetit të tregut të punës dhe sofistikimit të biznesit gjë që përmirëson konkurrencën e vendeve të botës (Sayed Mahdi Vesal, Mohsen Nazari, Mostafa Hosseinzadeh, Reza Shamsaddini & Khaled Naëaser 2013).

Kapitali është një faktor i rëndësishëm prodhimi. Rëndësia e saj është për shkak të rolit të saj në çdo proces prodhimi - faktori që lidh të gjithë të tjerët (burimet natyrore, fuqia punëtore dhe sipërmarrja) në çdo rast për të furnizuar tregun me mallrat dhe shërbimet më të kërkuara. Pa kapital, faktorët tjerë mbeten të papërdorura ose më pak të përdorura. Qasja e efektshme në kapital është e rëndësishme për kompanitë që të bëjnë investime afatgjata të nevojshme për të rritur nivelet e produktivitetit (Levine, 2005). Kështu, zhvillimi i tregut financiar është reflektuar në ndarjen e burimeve financiare për ato projekte sipërmarrëse ose investuese me normat më të larta të pritura të kthimit, në vend të atyre të lidhura politikisht. Për më tepër sofistikimi i tregut të kapitalit mundëson sigurimin e kapitalit nga burime të ndryshme (ËEF 2014). Për të përmbushur të gjitha këto funksione, tregjet financiare kanë nevojë për rregullim të duhur për të mbrojtur investitorët dhe aktorët e tjerë në ekonomi. Integrimi i tregjeve të kapitalit ka një ndikim pozitiv në rritjen ekonomike dhe faktorët kryesorë në të cilët tregu i kapitalit ndikon pozitivisht në rritjen ekonomike janë kapitalizmi i tregut të aksioneve, lëvizja e kapitalit, vlera e tregtuar, indekset e stokeve, emigrantët dhe në një masë më të madhe, investime të vogla të portofolave të huaja (Otilia-Roxana Oprea and Ovidiu Stoica 2018).

Që një ekonomi të përparojë, është e rëndësishme të jemi të shkathët në miratimin e teknologjive ekzistuese për të rritur produktivitetin e industrive të saj (Barro dhe Sala-i-Martin,

2003). Gjithashtu zhvillimi i teknologjive të informacionit dhe komunikimit ka efekt pozitiv në rritjen ekonomike, por magnituda dallon mvarësisht nga teknologjia e shfrytëzuar (Elena Toader, Bogdan Narcis Firtescu, Angela Roman and Sorin Gabriel Anton 2018)

Madhësia e tregut është një nga pasuritë e një vendi e cila ndikon në produktivitetin përmes mundësive për të arritur ekonomi të shkallës. Në epokën e globalizmit, tregjet ndërkombëtare janë bërë një zëvendësues për tregjet e vendit, veçanërisht për vendet e vogla. Kështu, eksportet dhe anëtarësimi në integrimin rajonal (i cili lejon qasje më të lirë dhe më të thjeshtë në tregjet e tjera) mund të mendohet si një zëvendësim i kërkesës së brendshme në përcaktimin e madhësisë së tregut për firmat e një vendi (Parteka dhe Ęolszczak-Derlacz 2013).


Sofistikimi i biznesit ka të bëjë me sasinë dhe cilësinë e furnizuesve lokalë, ofruesve të shërbimeve dhe institucioneve të lidhura në një fushë të caktuar dhe shtrirjes së ndërveprimeve të tyre. Ai rrit produktivitetin për shkak të efikasitetit më të lartë, krijon mundësi më të mëdha për inovacion në procese dhe produkte dhe redukton barrierat e hyrjes për firmat e reja (Delgado et al, 2010). Për më tepër, operacionet dhe strategjitë e avancuara të firmave (markimi, marketingu, shpërndarja, proceset e avancuara të prodhimit dhe prodhimi i produkteve unike dhe të sofistikuar) kalojnë në ekonomi dhe çojnë në procese të sofistikuar dhe moderne të biznesit në të gjithë sektorët e biznesit të vendit, për produktivitet më të lartë (ĘEF 2013). Disa studime empirike konfirmojnë rëndësinë e operacioneve të kompanive dhe strategjitë për produktivitetin (Bloom dhe Van Reenen, 2007).

Inovacioni ka ndikim pozitiv mbi produktivitetin (Grossman dhe Helpman, 1991 dhe Furman et al, 2002), Risia teknologjike është shumë e rëndësishme për ekonominë që nuk mund të përmirësojnë produktivitetin e tyre vetëm duke integruar dhe përshtatur teknologjitë ekzogjene (Romer, 1990).

3.KONKURENCA GLOBALE

Duke u bazuar në të dhënat e marra nga Banka Botërore kemi bërë një analizë empirike, ku kemi krahasuar rezultatet mesatare të Indeksit Global të Konkurrencës (GCI) të shteteve të Evropës Juglindore duke i ndarë në 2 grupe, ato që janë pjesë e Unionit Evropian dhe ato që nuk janë pjesë e këtij Unioni, dhe rritjes mesatare të këtyre rezultateve në periudhën 2006–2017. Qëllimi i kësaj analize krahasuese ishte të zbulojë gjendjen e konkurrencës së këtyre vendeve në periudhën e analizuar dhe të shihet përmirësimi ose përkeqësimi i shtyllave të konkurrencës për këtë periudhë kohore. Për të pasur një pasqyrë të qartë kemi analizuar secilin grup, kërkesat themelore, përmirësuesit e efikasitetit si dhe faktorët e inovacionit.

Figura 1 Konkureshmëria mesatare globale e vendeve të Evropës Juglindore




Burimi: WEF (2007-2017) dhe llogaritjet e autorit.

Figura 1 tregon nivelin mesatar të Indeksit Global të konkurrencës dhe nivelet mesatare të grupeve të Indeksit Global të konkurrencës të ndara në 2 grupe, shtetet të cilat janë pjesë e Unionit Evropian dhe ato që janë në tranzicion. Këtu shihet që GCI-ja (GCI-ja më tutje në tekst do të tregojë indeksin global të konkurrencës) për periudhën 2007-2017 në shtetet e vëzhguara të cilat janë pjesë e Unionit Evropian performon më mirë se sa në shtetet të cilat janë në tranzicion. Sllovenia ka vlerë mesatare më të lartë të GCI-së me 4.39 dhe ndiqet nga Bullgaria, Romania,

Kroacia dhe Greqia. Te shtetet në tranzicion performon më mirë Mali i Zi, i cili konkurren me shtete e zhvilluara dhe ndiqet nga Maqedonia Veriore, Serbia dhe Shqipëria, kurse më dobët performon Bosnja dhe Hercegovina e cila vlerën mesatare të e IGK-së e ka 3.76. Te të gjithë shtetet vërejmë që më mirë qëndrojnë te kërkesat themelore, me theks të veçantë Sllovenia, pastaj kërkesat e efikasitetit, kurse më dobët janë të faktorët e inovacionit.

Figura 2 Rritja mesatare në përqindje konkurrancës globale në vendet e Evropës Juglindore (% , 2007–2017).



Burimi: WEF (2007-2017) dhe llogaritjet e autorit.


Figura 2 tregon nivelin mesatarë të rritjes së konkurrancës totale dhe nivelet mesatare të rritjes së tre grupeve të shtyllave të konkurrancës për shtetet e Evropës Juglindore, të ndara në 2 grupe, ato që janë pjesë e Unionit Evropian dhe ato që nuk janë. Te anëtarët e Unionit Evropian gjatë periudhës së vëzhguar më shumë përmirësime ka bërë Bullgaria, e cila në vitin 2007 u bë pjesë e këtij bashkimi, ndiqet nga Romania e cila te kërkesat themelore dhe përmirësuesit e efikasitetit ka ecur mirë, por sa i përket faktorëve të inovacionit është dobësuar. Situatë e ngjashme ka ndodhur edhe me Kroacinë, e cila në vitin 2013 u bë pjesëtare e Unionit Evropian. Greqia është përkeqësuar në të 3 shtyllat, ajo u ndikua thellë nga kriza ekonomike botërore e vitit 2008. Sllovenia ka dobësuar te kërkesat themelore dhe përmirësuesit e efikasitetit, kurse është

përmirësuar te inovacionet. Ky shtet gjithashtu pati pasoja të rënda nga kriza ekonomike Botërore, por shpejt arriti të rimëkëmbet. Te shtetet në tranzicion përmirësim më të madh gjatë periudhës së analizuar ka bërë Shqipëria, me 2.3%. Ajo është zhvilluar në të gjitha shtyllat, por më shumë në fushën e faktorëve të inovacionit, pas saj riradhitet Maqedonia Veriore e cila po ashtu ka marë drejtim të mirë. Serbia dhe Mali i Zi janë zhvilluar te kërkesat themelore, kurse Bosnja dhe Hercegovina është zhvilluar te kërkesat e efikasitetit, por përkeqësohet te kërkesat themelore dhe faktorët e inovacionit.

1.1 Konkurrenca globale ne fushën e kërkesave themelore

Konkurrenca globale në fushën e kërkesave themelore ka 4 pilare të rëndësishme të cilat janë: institucionet, infrastruktura, makroekonomia dhe shëndetësia dhe arsimi fillor të cilat luajnë një rol shumë të rëndësishëm për mbarimin e fazës së tranzicionit.

Figura 3 Rritja mesatare në përqindje kërkesave themelore në vendet e Evropës Juglindore (% , 2007-2017).




Burimi: WEF (2007,2017) dhe llogaritjet e autorit.

Figura 3 tregon nivelin mesatar të kërkesave themelore dhe nivelet mesatare të rritjes ose zvogëlimit të shtyllave të kërkesave themelore të ndara në dy grupe, shtetet që janë pjesë e Unionit Evropian dhe ato që nuk janë. Te pjesëtarët e Bashkësisë Evropian Bullgaria dhe Romania janë zhvilluar të institucionet, infrastruktura dhe stabiliteti makroekonomik, kurse kanë dobësim te pilari i shëndetësisë dhe arsimit fillor. Greqia e ndikuar thellë nga kriza ekonomike e vitit 2008 është dobësuar shumë te stabiliteti makroekonomik, institucionet dhe shëndetësia dhe arsimit fillor. Sllovenia poashtu në të njëjtat pilare ka dobësim, por me intenzitet më të ulët. Edhe Sllovenia pasojat i ka nga kriza ekonomike botërore. Kroacia ka përkeqësuar te institucionet dhe shëndetësia dhe arsimit fillor, kurse është zhvilluar të stabiliteti makroekonomik. Te shtetet në tranzicion Bosnja dhe Hercegovina është përkeqësuar të institucionet dhe shëndetësia dhe arsimit fillor. Mali i Zi është zhvilluar dukshëm te institucionet, me 9.1%, kurse është dobësuar të stabiliteti makroekonomik. Maqedonia Veriore dhe Shqipëria kanë përmirësim te institucionet dhe stabiliteti makroekonomik, kurse të shëndetësia dhe arsimit fillor janë dobësuar. Serbia ka përmirësime të vogla te institucionet, stabiliteti makroekonomik dhe shëndetësia dhe arsimit primar. Te pilari i infrastrukturës shihet që të gjitha shtetet kanë zhvillim, por më shumë përmirësim është bërë te shtetet në tranzicion, me theks të veçantë në Shqipëri, pasi që këto shtete kanë patur infrastrukturë më të dobët.

2.2 Konkurrenca globale në fushën e përmirësuesve të efikasitetit

Konkurrenca globale në fushën përmirësuesve të efikasitetit ka 5 pilarë edhe atë: shkollimi i lartë dhe trajnimet, efikasiteti i tregut të mallrave, efikasiteti i tregut të punës, zhvillimi i tregut financiar, përgaditja teknologjike dhe madhësia e tregut.

Fig. 4 Rritja mesatare e konkurrencës globale të shteteve të Evropës Juglindore fushën e përmirësuesve të efikasitetit (% , 2007–2017).




Burimi: WEF (2007-2017) dhe llogaritjet e autorit.

Figura 4 tregon nivelin mestar të përmirësuesve të efikasitetit dhe nivelet mesatare të rritjes ose zvogëlimit të shtyllave të përmirësuesve të efikasitetit të ndara në dy grupe, shteteve që janë pjesë e Unionit Evropian dhe atyre që nuk janë. Te pilari i arsimit të lartë dhe trajnimeve dobësim kemi vetëm në Greqi, vendet tjera zhvillohen në këtë drejtim, bie në sy zhvillimi i Shqipërisë me 3.9%. Efikasiteti i tregut të mallrave është përmirësuar në Bullgari, Romani, Sllloveni, Mal të Zi, Maqedoninë Veriore, Serbi dhe Shqipëri, kurse është përkeqësuar në Greqi, Kroaci dhe Bosnjë dhe Hercegovinë. Efikasiteti i tregut të punës është dobësuar të të gjitha shtetet, përpos Maqedonisë Veriore, kjo është rezultat i krizës ekonomike globale. Zhvillimi i tregut financiar po ashtu ka dobësim te të gjitha shtetet përpos Maqedonisë Veriore dhe Shqipërisë. Te përgaditja teknologjike të gjitha shtetet kanë performuar mirë në këtë drejtim. Madhësia e tregut ka ra në Greqi dhe Sllloveni, kurse në shtetet tjera ka përmirësime të vogla.

2.3 Konkurrenca globale në fushën e inovacionit dhe faktorëve të sofistikimit

Konkurrenca globale ne fushën e inovacionit dhe faktorëve të sofistikimit ka 2 pilarë, edhe atë: sofistikimi i biznesit dhe inovacioni

Fig. 5 Rritja mesatare e konkurrencës globale të shteteve të Evropës Juglindore në fushën e inovacionit dhe faktorëve të sofistikimit (% , 2006–2017).




Burimi: WEF (2007-2017) dhe llogaritjet e autorit.

Figura 5 na tregon mesataren e ndryshimit të faktorëve të inovacionit dhe sofistikimit në shtetet e Evropës Juglindore të ndara në 2 grupe, ato që janë pjesë e Unionit Evropian dhe ato që nuk janë. Pjesëtarët e Unionit Evropian edhe pse kanë indeksin global të konkurrencës më të lartë brenda kësaj periudhe u kanë përkeqësuar. Greqia, Kroacia dhe Romania kanë dobësim edhe në pilarin e inovacionit edhe në atë të sofistikimit të biznesit, Sllovenia te sofistikimi i biznesit është zhvilluar mirëpo është dobësuar te inovacionet, kurse Bullgaria në të dy pilaret ka performuar mirë. Te shtetet në tranzicion bie në sy zhvillimi që ka bërë Shqipëria gjatë kësaj periudhe me 3.1% rritje në të dy shtyllat, e ndjekur nga Maqedonia Veriore me 1.2%. Mali i Zi po ashtu ka përmirësim të lehtë, kurse Bosnja dhe Hercegovina dhe Serbia janë përkeqësuar.

2.4 Krahasim i konkurrencës Globale mes shteteve BE dhe jo-BE

Figura 6: Mesatarja e Konkurrencës Globale në shtetet e Evropës Juglindore




Burimi: WEF (2008-2017) dhe kalkulimet e autorit.

Në grafikonin më sipër kemi mesataren e viteve 2008-2017 të të gjitha shtyllave të Indeksit Global të Konkurrencës, të ndara në 2 grupe: mesatarja e shteteve të Evropës Juglindore që janë pjesë e Unionit Evropian dhe mesatarja e shteteve të Evropës Juglindore që nuk janë pjesë e këtij unioni. Në shikim të parë vërehet që pjesëtarët e Bashkimit Evropian performojnë më mirë te infrastruktura, stabiliteti makroekonomik, shëndetësia dhe arsimi fillor, arsimi i lartë dhe trajnimet, efikasiteti i tregut të mallrave, përgatitja teknologjike, madhësia e tregut, sofistikimi i biznesit dhe inovacionet. Performojnë ngjashëm te institucionet, kurse shtetet jo pjesëtarë të Unionit Evropian qëndrojnë më mirë te tregu i punës dhe sofistikimi i tregut financiar. Nga të dhënat shihet qartë që vendet që kanë arritur të jenë pjesë e Bashkimit Evropian kanë Indeksin e Konkurrencës Globale më të mirë dhe janë më konkurrenente në shumicën e shtyllave që e përbëjnë këtë indeks.

3. Analiza e shtyllave te Indeksit Global të Konkurrencës në Evropën Juglindore

3.1 Analiza Indeksit Global të Konkurrencës në Bosnjë dhe Hercegovinë

Figura 7: Mesatarja e shtyllave të GCI-së në Bosnjë dhe Hercegovinë



Burimi: WEF (2008-2017) dhe kalkulimet e autorit.

Figura 7 tregon mesataren e gjithë shtyllave të GCI-së në periudhën 2008 dhe 2017 në Bosnjë dhe Hercegovinë. Gjatë periudhës 2008-2017 kemi përmirësim të Indeksit Global të Konkurrencës për 4 shkallë, nga vendi i 107-të në vitin 2008-të në vendin e 103-të në vitin 2017. Në vazhdim do ti tregojmë anët me te forta dhe te dobëta të cdo nenpilari:


- Te *institucionet* situata qëndron e vështirë, nëse shkohet në nën detaje shihet që ka probleme të të drejtat pronësore, mbrojtja e pronësisë intelektuale, besimi publik ndaj politikanëve, liria juridike, hedhjet e shpenzimeve qeveritare, barra e rregullave qeveritare, efikasiteti i kornizës ligjore në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, efikasiteti i kornizës ligjore në rregullat sfiduese, transparenca e bërjes së politikave qeveritare, krimi i organizuar dhe forca e standardeve të auditimit dhe raportimit.
- *Infrastruktura* e këtij shteti në përgjithësi është e dobët
- Te pilari i *stabilitetit makroekonomik* vërejmë që balancimi i buxhetit qeveritar dhe borxhi i qeverisë janë përkeqësuar pas krizës ekonomike globale të vitit 2008, por pastaj përsëri marrin kahje të mirë. Shkalla e kursimit qeveritar është shumë e ulët, kurse shkalla e kredisë në vend është e lartë.

- Te pilari i *shëndetësisë dhe arsimit fillor* Bosnja dhe Hercegovina qëndron më mirë nga të gjitha pilaret tjera, por këtu vërehet që cilësia e arsimit fillor ka ra nga vendi i 57-të në vitin 2008 në vendin e 84-të në vitin 2017.
- Te *arsimi i lartë dhe trajnimet* është rritur regjistrimi sekondar dhe terciar, por ka rënie cilësia e sistemit arsimor. Disponueshmëria lokale e shërbimeve kërkimore dhe trajnuese dhe shkalla e trajnimit të stafit është shumë e ulët.
- *Efikasiteti i tregut të mallrave është* dobësuar gjatë periudhës së analizuar. Ky shtet qëndron dobët te intensiteti i konkurrencës lokale, shtrirja e mbizotërimit të tregut, shtrirja dhe efekti i tatimit, numri dhe koha e nevojshme për të filluar biznes, kostot e politikës bujqësore, ndikimi i rregullave të biznesit në IDH, shkalla e orientimit të klientit dhe sofistikimi i blerësit. Norma tatimore është përmirësuar nga vendi i 66-të në vitin 2008, në vendin e 19-të në vitin 2017, kurse importet si përqindje e PBB-së kryesisht janë të larta.
- *Efikasiteti i tregut të punës* është dobësuar, me theks të vecantë janë përkeqësuar praktikatat e punësimit dhe pushimit nga puna dhe pjesëmarrja e femrave në fuqinë punëtore. Qëndron kryesisht dobët te bashkëpunimi punëtor punëdhënës, pagimi dhe produktiviteti dhe kapaciteti i vendit për të ruajtur dhe tërhequr talent.
- Te *sofistikimi tregut financiar* Bosnja dhe Hercegovina është përkeqësuar për vitet e analizuara, kryesisht qëndron dobët te disponueshmëria e shërbimeve financiare, mundësia e shërbimeve financiare, financimi përmes tregut lokal të kapitalit lokal, riziko kapitali² dhe qëndrueshmëria e bankave.
- Të *përgatitja teknologjike* ka përmirësim për 40 shkallë, nga vendi i 109-të në vitin 2008, në vendin e 69-të në vitin 2017. Është rritur disponueshmëria e teknologjive të fundit dhe thithja e nivelit të fortë të teknologjisë.
- Te *madhësia e tregut* vërehet që Bosnja dhe Hercegovina nuk ka treg të madh, por eksportet si përqindje e PBB-së janë rritur, nga vendi i 82-të në vitin 2013, në vendin e 46-të në vitin 2017.
- Te pilari i *sofistikimit të biznesit* shihet që sasia dhe cilësia e furnizuesit lokal, sofistikimi i procesit të prodhimit, shtrirja e marketingut dhe gatishmëria për të deleguar autoritetin janë përmirësuar deri në vitin 2014 e pastaj dobësohen përsëri. Është shumë e dobët natyra e avantazhit konkurrues, gjerësia e zinxhirit të vlerës dhe kontrolli i shpërndarjes ndërkombëtare.
- Te *inovacionet* kemi zhvillim deri në vitin 2013 dhe 2014 e pastaj përkeqësohet cilësia e institucioneve kërkimore dhe shkencore, shpenzimet e kompanisë për kërkim dhe zhvillim, bashkëpunimi kërkimor universitar-industri, blerja e produkteve të teknologjisë së përparuar dhe disponueshmëria e shkencëtarëve dhe inxhinierëve.

² Kapitali i sipërmarrjes është një formë e kapitalit privat dhe një lloj financimi që investitorët u sigurojnë kompanive fillestare dhe bizneseve të vogla për të cilat besohet se kanë potencial rritjeje afatgjatë. Kapitali i sipërmarrjes në përgjithësi vjen nga investitorë të mirë, bankat e investimeve dhe çdo institucion tjetër financiar

3.2 Analiza e Indeksit Global të Konkurrencës në Bullgari

Figura 8: Mesatarja e shtyllave të GCI-së në Bullgari



Burimi: WEF (2008-2017) dhe kalkulimet e autorit.


Figura 8 tregon mesataren e gjithë shtyllave të GCI-së në periudhën 2008 dhe 2017 në Bullgari. Indeksi Global i Konkurrencës në këtë shtet për periudhën 2008-2017 është përmirësuar për 27 shkallë, nga vendi i 76-të në vitin 2008, në vendin e 49-të në vitin 2017. Në vazhdim do ti tregojmë anët me te forta dhe te dobëta të çdo nenpilari:

- Te *institucionet* edhe pse është përmirësuar, Bullgaria qëndron dobët dhe ka probleme të nën shtyllat si: të drejtat pronësore, mbrojtja e pronësisë intelektuale, devijimi i fondeve publike, liria juridike, favorizimi në vendimet e zyrtarëve qeveritarë, efikasiteti i kornizës ligjore në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, transparenca e bërjes së politikave qeveritare, krimi i organizuar dhe besueshmëria e shërbimeve policore.
- *Infrastruktura* në përgjithësi ka pësuar rënie.
- *Stabiliteti makroekonomik* është përmirësuar për periudhën e vëzhguar dhe Bullgaria ka përparësi konkurruese në këtë pilar, në vitin 2017-të zë vendin e 25-të në indeksin global të konkurrencës. Është i mirë menaxhuar bilanci i buxhetit qeveritar, kurse borxhi i qeverisë, edhe pse ka rritje gjatë krizës ekonomike globale, ajo shpejt është përmirësuar.

- Pilari i *shëndetësisë dhe arsimit primar* është dobësuar, jetëgjatësia ka ra nga vendi i 55-të në vitin 2008, në vendin e 74-të në vitin 2017.
- Te *edukimi i lartë dhe trajnimet* regjistrimi sekondar ka ra nga vendi i 13-të në vitin 2008, në vendin e 52-të në vitin 2017, kurse regjistrimi terciar është rritur. Është dobësuar disponueshmëria lokale e shërbimeve kërkimore dhe trajnuese, kurse shkalla e trajnimit të stafit vazhdimisht është e dobët.
- *Efikasiteti i tregut të mallrave* ka përmirësim të shtrirja dhe efekti i tatimit, norma tatimore dhe mbizotërimi i pronësisë së huaj. Është shtuar koha e nevojshme për të filluar biznes. Shkalla e tarifave të tregtisë është e ulët, kurse importet si përqindje e PBB-së janë të larta.
- Te *efikasiteti i tregut të punës* vërejmë që Bullgaria qëndron dobët të bashkëpunimi punëtor-punëdhënës, mbështetja në menaxhim profesional dhe kapaciteti i vendit për të ruajtur dhe tërhequr talent. Është përkeqësuar pagimi dhe produktiviteti, nga vendi i 42-të në vitin 2008, në vendin e 88-të në vitin 2017, kurse ka përparësi konkurruese të participimi i femrës në fuqinë punëtore.
- Te *sofistikimi i tregut financiar* ka përmirësim në disponueshmërinë dhe mundësinë e shërbimeve financiare, financimi përmes tregut lokal të kapitalit lokal dhe kapitalit çka e zotërojnë firmat për rast rreziku. Përgatitja teknologjike është përmirësuar, është rritur dukshëm disponueshmëria e teknologjive të fundit, thithja e nivelit të fortë të teknologjisë dhe IHD dhe transferimi i teknologjisë.
- Te *madhësia e tregut* ky shtet në përgjithësi qëndron mirë, eksportet si përqindje e PBB-së janë të larta.
- *Sofistikimi i biznesit* dobësohet deri në vitin 2013 dhe 2014 e pastaj merr kahje më të mirë, një lëvizje e tillë ndodh të sasia dhe cilësia e furnizuesit lokal, gjendja e zhvillimit të grupimeve, natyra e avantazhit konkurrues, gjerësia e zinxhirit të vlerës dhe kontrolli i shpërndarjes ndërkombëtare. Sofistikimi i procesit të prodhimit është përmirësuar, kurse gatishmëria për të deleguar autoritetin është kryesisht e dobët. Një lëvizje e ngjashme si të sofistikimi i biznesit ndodh edhe të *i*
- *novacionet*, duke filluar nga kapaciteti për inovacion, cilësia e institucioneve kërkimore dhe shkencore, shpenzimet e kompanisë për kërkim dhe zhvillim, bashkëpunimi kërkimor universitar-industri, blerja e produkteve të teknologjisë së përparuar e deri të disponueshmëria e shkencëtarëve dhe inxhinierëve. Te patentat e shërbimeve ky shtet vazhdimisht ka përparësi konkurruese.

3.3 Analiza e Indeksit Global të Konkurrencës në Greqi

Figura 9: Mesatarja e shtyllave të GCI-së në Greqi



Burimi: WEF (2008-2017) dhe kalkulimet e autorit.


Figura 9 tregon mesataren e gjithë shtyllave të GCI-së në periudhën 2008 dhe 2017 në Greqi. Ky shtet gjatë periudhës 2008-2017 ka pësuar rënie në Indeksin Global të Konkurrencës, nga vendi i 67-të në vitin 2008, në vendin e 87-të në vitin 2017. Në vazhdim do ti tregojmë anët me te forta dhe te dobëta të çdo nenpilari:

- *Institucionet* janë përkeqësuar për 29 shkallë, nga vendi i 58-të në vitin 2008, në vendin e 87-të në vitin 2017. Me theks të veçantë janë dobësuar të drejtat pronësore, devijimi fondeve publike, besimi publik ndaj politikanëve, favorizimi në vendimet e zyrtarëve qeveritarë, hedhjet e shpenzimeve qeveritare, efikasiteti i kornizës ligjore në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, krimi i organizuar dhe forca e standardeve të auditimit dhe raportimit.
- *Infrastruktura* e këtij shteti është e mirë dhe ka përparësi konkurruese në këtë pilar.
- *Stabiliteti makroekonomik* është përkeqësuar pas krizës ekonomike botërore nga e cila u ndikua shumë. Balancimi i buxhetit qeveritar u përkeqësua dukshëm deri në vitin 2012 ku ky shtet zë vendin e 139-të të GCI-ja e pastaj filloi të përmirësohet. Borxhi i qeverisë edhe pse ishte i lartë në vitin 2013 arriti të radhitet në vendin e 147 në listë, e pastaj filloi nga pak të zbutet.

- *Pilari i shëndetësisë dhe arsimit fillor* është dobësuar gjatë periudhës së vëzhguar, por Greqia te jetëgjatësia dhe vdekshmëria e foshnjave vazhdimisht ka përparësi konkurruese.
- *Te arsimi i lartë dhe trajnimet* regjistrimi sekondar është i lartë, kurse regjistrimi terciar vite me radhë mban vendin e parë në listën e GCI-së, mirëpo cilësia e sistemit arsimor është dobësuar nga vendi i 82-të në vitin 2008, në vendin e 106-të në vitin 2017.
- *Efikasiteti i tregut të mallrave* po ashtu dëmtohet nga kriza ekonomike globale, veçanërisht ndjehet në vitet 2013-2014, e pastaj fillon të përmirësohet përsëri. Një lëvizje e tillë ndodh te intensiteti i konkurrencës lokale, shtrirja e mbizotërimit të tregut, shtrirja dhe efekti taksimit, shkalla totale e taksave dhe kostot e politikës bujqësore. Është ulur dukshëm numri i procedurave të nevojshme për të filluar biznes, kurse shkalla e tarifave të tregtisë kryesisht është e mirë. Importet si përqindje e PBB-së në Greqi janë të ulta, me tendencë për tu rritur gjatë kësaj periudhe.
- *Te efikasiteti i tregut të punës* vërejmë që bashkëpunimi në marrëdhëniet punëtor-punëdhënës, fleksibiliteti i përcaktimit të pagës, praktikat e punësimit dhe pushimit nga puna, pagimi dhe produktiviteti edhe pse kanë qenë të dobëta, pas krizës janë dobësuar edhe më shumë e pastaj kanë filluar të përmirësohen. Kapaciteti i vendit për të ruajtur dhe tërhequr talent është i dobët.
- *Sofistikimi i tregut financiar* është dobësuar për 66 shkallë, nga vendi i 67-të në vitin 2008, në vendin e 133-të në vitin 2017, ku ka ra dukshëm disponueshmëria dhe mundësia e shërbimeve financiare, financimi përmes tregut lokal të kapitalit lokal, lehtësia e hyrjes në kredi, riziko kapitali dhe qëndrueshmëria e bankave.
- *Te përgatitja teknologjike* Greqia qëndron mirë te disponueshmëria e teknologjive të fundit dhe te adaptimi i TIK-ut, kurse IHD dhe transferimi i teknologjisë është i dobët.
- *Madhësia e tregut të brendshëm dhe të jashtëm* edhe pse gjatë periudhës së vëzhguar është zvogëluar, përsëri është e mirë, PBB-ja është e lartë, kurse eksportet janë të ulta.
- *Sofistikimi i biznesit* është dobësuar në përgjithësi, me theks të veçantë te sasia dhe cilësia e furnizuesit lokal, gjendja e zhvillimit të grupimeve, gjerësia e zinxhirit të vlerës, shtrirja e marketingut dhe gatishmëria për të deleguar autoritetin.
- *Inovacionet* janë dobësuar gjatë kësaj periudhe, ka ra kapaciteti për inovacion, bashkëpunimi kërkimor universitar-industri dhe blerja e produkteve të teknologjisë së përparuar, kurse te disponueshmëria e shkencëtarëve dhe inxhinierëve dhe patentat e shërbimeve Greqia ka përparësi konkurruese vazhdimisht.

3.4 Analiza e Indeksit Global të Konkurrencës në Kroaci

Figura 10: Mesatarja e shtyllave të GCI-së në Kroaci



Burimi: WEF (2008-2017) dhe kalkulimet e autorit.


Figura 10 tregon mesataren e gjithë shtyllave të GCI-së në periudhën 2008 dhe 2017 në Kroaci. Në periudhën 2008-2017 indeksi global i konkurrencës në këtë shtet është përkeqësuar për 23 shkallë, nga vendi i 51-të në vitin 2008, në vendin e 74-të në vitin 2017. Në vazhdim do ti tregojmë anët me te forta dhe te dobëta te cdo nenpilar:

- *Institucionet* janë dobësuar për 36 shkallë, nga vendi i 66-të në vitin 2008, në vendin e 102-të në vitin 2017. Nga ky dobësim më tepër janë prekur të drejtat pronësore, devijimi i fondeve publike, besimi publik ndaj politikanëve, liria juridike, favorizimi në vendimet e zyrtarëve qeveritarë, hedhjet e shpenzimeve qeveritare, barra e rregullave të qeverisë, efikasiteti i kornizës ligjore në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe forca e standardeve të auditimit dhe raportimit.
- *Infrastruktura* e përgjithshme në Kroaci është e mirë, ky shtet ka përparësi konkurruese në këtë pilar.
- Te *stabiliteti makroekonomik* balancimi i buxhetit qeveritar është përmirësuar, nga vendi i 103-të në vitin 2006 në vendin e 39-të në vitin 2017, kurse borxhi i qeverisë është rritur nga vendi i 48-të në vitin 2006, në vendin e 115-të në vitin 2017.
- Te pilari i *shëndetësisë dhe arsimit fillor* Kroacia është zhvilluar dhe është rritur dukshëm cilësia e arsimit fillor dhe shkalla e regjistrimit në arsim fillor.

- Pilari i *arsimit të lartë dhe trajnimeve* është përkeqësuar, është rritur regjistrimi terciar, por ka ra cilësia e sistemit arsimor, qasja në internet në shkolla dhe disponueshmëria lokale e shërbimeve kërkimore dhe trajnuese. Shkalla e trajnimit të stafit dobësohet nga vendi i 64-të në vitin 2008 në vendin e 130 në vitin 2017.
- *Efikasiteti i tregut të mallrave* është dobësuar pas krizës ekonomike globale e pastaj përsëri fillon të zhvillohet, kryesisht te intensiteti i konkurrencës lokale, shtrirja e mbizotërimit të tregut, shtrirja dhe efekti i tatimit, norma tatimore, kostot e politikës bujqësore, mbizotërimi i pronësisë së huaj, ndikimi i rregullave të biznesit në IDH, shkalla e orientimit të klientit dhe sofistikimi i blerësit. Është ulur koha e nevojshme për të filluar biznes dhe shkalla e tarifave të tregtisë.
- *Efikasiteti i tregut të punës* ka pësuar rënie prej 39 shkallësh, nga vendi i 68-të në vitin 2008, në vendin e 107-të në vitin 2017. Është përkeqësuar bashkëpunimi në marrëdhëniet punëtor punëdhënës, praktikat e punësimit dhe pushimit nga puna, pagimi dhe produktiviteti dhe mbështetja në menaxhim profesional. Kapaciteti i vendit për të ruajtur dhe tërhequr talent në përgjithsi është shumë i ulët.
- *Sofistikimi i tregut financiar* po ashtu ka pësuar rënie duke filluar nga disponueshmëria e shërbimeve financiare, financimi përmes tregut lokal të kapitalit lokal, lehtësia e hyrjes në kredi deri te riziko kapitali.
- Te pilari i *përgatitjes teknologjike* ky shtet ka përparësi konkurruese vazhdimisht, me theks të veçantë te abonimet fikse në internet me bandë të gjerë, gjerësia e bandës në internet dhe abonimet me celularë.
- *Madhësia e tregut të brendshëm* është zvogëluar, kurse eksportet si përqindje e PBB-së janë rritur, nga vendi i 67-të në vitin 2013 në vendin e 27-të në vitin 2017, pasi Kroacia është bërë anëtare e Unionit Evropian.
- *Sofistikimi i biznesit* është dobësuar te sasia e furnizuesit lokal, natyra e avantazhit konkurruese, gjerësia e zinxhirit të vlerës, kontrolli i shpërndarjes ndërkombëtare, shtrirja e marketingut dhe gatishmëria për të deleguar autoritetin.
- *Inovacionet* janë përkeqësuar për 61 shkallë, nga vendi i 45-të në vitin 2006, në vendin e 106-të në vitin 2017. Ka rënie të dukshme te kapaciteti për inovacion, shpenzimet e kompanive në kërkim dhe zhvillim, bashkëpunimi kërkimor universitar-industri, blerja e produkteve të teknologjisë së përparuar dhe disponueshmëria e shkencëtarëve dhe inxhinierëve. Te patentat e shërbimeve Kroacia vazhdimisht ka përparësi konkurruese.

3.5 Analiza e Indeksit Global të Konkurrencës në Mal të Zi

Figura 11: Mesatarja e shtyllave të GCI-së në Mal të Zi



Burimi: WEF (2008-2017) dhe kalkulimet e autorit.

Figura 11 tregon mesataren e gjithë shtyllave të GCI-së në periudhën 2008 dhe 2017 në Mal të Zi. Indeksi global i konkurrencës në këtë shtet ka pësuar rënie nga vendi i 65-të në vitin 2008, në vendin e 77-të në vitin 2017. Në vazhdim do ti tregojmë anët e forta dhe te dobëta te cdo nenpilari:


- *Institucionet* janë dobësuar kryesisht te të drejtat pronësore, efikasiteti i kornizës ligjore në rregullat sfiduese, kostot e biznesit nga terrorizmi, kostot e biznesit nga krimi dhe dhuna, krimi i organizuar, besueshmëria e shërbimeve policore dhe forca e standardeve të auditimit dhe raportimit.
- *Infrastruktura* është përmirësuar për periudhën e vëzhguar, me theks të veçantë infrastruktura rrugore e cila ka lëvizur nga vendi i 119-të në vitin 2008 në vendin e 88-të në vitin 2017.
- *Stabiliteti makroekonomik* është dobësuar dukshëm, balancimi i buxhetit qeveritar nga vendi i 28-të në vitin 2008 ka ra në vendin e 104-të në vitin 2017, kurse borxhi i qeverisë nga vendi i 56-të në vitin 2008 ka ra në vendin e 102-të në vitin 2017.
- *Pilari i shëndetësisë dhe arsimit fillor* ka rënie në cilësinë e arsimit fillor dhe shkallën e regjistrimit në arsim fillor. Te arsimi i lartë dhe trajnimet vërehet rënie në

regjistrimin sekondar, cilësinë e arsimit të matematikës dhe shkencës dhe shkallën e trajnimit të stafit.

- Te *efikasiteti i tregut të mallrave* intensiteti i konkurrencës lokale është i dobët, është ulur koha e nevojshme për të filluar biznes dhe norma tatimore, kurse shkalla e tarifave të tregtisë është kryesisht e mirë.
- *Efikasiteti i tregut të punës* është dobësuar te pagimi dhe produktiviteti dhe kapaciteti i vendit për të ruajtur dhe tërhequr talent, kurse bashkëpunimi në marrëdhëniet punëtor-punëdhënës është i dobët.
- Te *sofistikimi tregut financiar* është dobësuar disponueshmëria dhe mundësia e shërbimeve financiare, financimi përmes tregut lokal të kapitalit lokal, disponueshmëria e kapitalit për sipërmarrje dhe qëndrueshmëria e bankave. Lehtësia e hyrjes në kredi ka lëvizur prej vendit të 29-të në vitin 2008, në vendin e 84-të në vitin 2017.
- Te *përgatitja teknologjike* Mali i Zi qëndron mirë dhe kryesisht mban pozitat e njëjta.
- Te *madhësia e tregut* ky shtet ka dezavantazh konkurrues dhe qëndron vazhdimisht në fund të listës së Indeksit Global të Konkurrencës, madhësia e tregut të brendshëm dhe të huaj është shumë e vogël, PBB-ja po ashtu, kurse eksportet janë rritur nga vendi i 79-të në vitin 2013 në vendin e 45-të në vitin 2017.
- Te *sofistikimi i biznesit* Mali i Zi qëndron dobët te sasia e furnizuesit lokal dhe gjendja e zhvillimit të grupimeve dhe është përkeqësuar dukshëm te gatishmëria për të deleguar autoritetin.
- Te *inovacionet* është përmirësuar deri në vitin 2010 ku ka zënë vendin e 45-të, nga vendi i 88-të në vitin 2008 dhe pastaj është dobësuar duke zënë përsëri vendin e 88-të në vitin 2017. Një lëvizje e këtyllë ka ardhur nga ndryshimet në kapacitetin për inovacion, cilësinë e institucioneve kërkimore dhe shkencore, shpenzimet e kompanisë për kërkim dhe zhvillim, bashkëpunimi kërkimor universitar-industri, blerja e produkteve të teknologjisë së përparuar dhe disponueshmëria e shkencëtarëve dhe inxhinierëve.

3.6 Analiza e Indeksit Global të Konkurrencës në Maqedonisë Veriore

Figura 12: Mesatarja e shtyllave të GCI-së në Maqedoninë Veriore



Burimi: WEF (2008-2017) dhe kalkulimet e autorit.


Figura 12 tregon mesataren e gjithë shtyllave të GCI-së në periudhën 2008 dhe 2016 në Maqedoninë Veriore. Gjatë kësaj periudhe ky shtet është përmirësuar për 21 shkallë në indeksin global të konkurrencës, nga vendi i 89-të në vitin 2008, u radhit në vendin e 68-të në vitin 2016. Në vazhdim do ti tregojmë anët me te forta dhe te dobëta te cdo nenpilari:

- Te *institucione* Maqedonia Veriore u zhvillua për 23 shkallë, nga vendi i 90-të në vitin 2008, në vendin e 67-të në vitin 2017. U përmirësuan të drejtat pronësore, mbrojtja e pronësisë intelektuale, devijimi fondeve publike, besimi publik ndaj politikanëve, favorizimi në vendimet e zyrtarëve qeveritarë, barra e rregullave qeveritare, krimi i organizuar, besueshmëria e shërbimeve policore dhe hedhjet e shpenzimeve qeveritare.
- Te *infrastruktura* në Maqedoninë Veriore kemi zhvillim të cilësia e infrastrukturës së transportit ajror, nga vendi i 121-të në vitin 2008, në vendin e 51-të në vitin 2016.
- Te *stabiliteti makroekonomik* vërejmë që gjatë periudhës së vëzhguar balancimi i buxhetit të qeverisë është përkeqësuar, borxhi i qeverisë është rritur gradualisht, ndërsa shkalla e kursimit kombëtar është rritur dukshëm.

- Pilari i *shëndetësisë dhe arsimit fillor* është përkeqësuar, ka ra jetëgjatësia, cilësia e arsimit fillor dhe shkalla e regjistrimit në arsim fillor.
- *Arsimi i lartë dhe trajnimet* po ashtu janë dobësuar, ka rënie të regjistrimi sekondar, cilësia e sistemit arsimor, cilësia e arsimit të matematikës dhe shkencës, kurse qasja në internet në shkolla dhe disponueshmëria lokale e shërbimeve kërkimore dhe trajnuese është rritur. Shkalla e trajnimit të stafit është përkeqësuar deri kah viti 2012 e pastaj fillon të marrë kahe më të mirë.
- *Efikasiteti i tregut të mallrave* është përmirësuar për 64 shkallë, nga vendi i 98-të në vitin 2008, në vendin e 34-të në vitin 2016. Është rritur intensiteti i konkurrencës lokale, shtrirja e mbizotërimit të tregut, efektiviteti i politikës antimonopole, është përmirësuar shtrirja dhe efekti i tatimit, norma e tatimit, ndikimi i rregullave të biznesit në IDH, barra e procedurave doganore dhe shkalla e orientimit të klientit. Numri dhe koha e nevojshme për të filluar biznes janë ulur aq shumë sa që Maqedonia Veriore vite me rradhë mban vendet e para në botë.
- *Efikasiteti i tregut të punës* është zhvilluar të bashkëpunimi në marrëdhëniet punëtor-punëdhënës, praktikat e punësimit dhe pushimit nga puna, pagimi dhe produktiviteti, kurse fleksibiliteti i përcaktimit të pagës është përkeqësuar shumë. Kapaciteti i vendit për të ruajtur dhe tërhequr talent është shumë i dobët.
- *Sofistikimi i tregut financiar* është përmirësuar të disponueshmëria dhe mundësia e shërbimeve financiare, lehtësia e hyrjes në kredi dhe qëndrueshmëria e bankave. Te pilari i përgatitjes teknologjike Maqedonia Veriore është zhvilluar kryesisht të disponueshmëria e teknologjive të fundit, thithja e nivelit të fortë të teknologjisë, IHD dhe transferimi i teknologjisë dhe përdoruesit e internetit.
- Sa i përket *madhësisë së tregut* ky shtet ka dezavantazh konkurrues në këtë pilar, madhësia e tregut të brendshëm dhe të jashtëm është e vogël, PBB-ja është e ulët, kurse eksportet janë rritur nga vendi i 45-të në vitin 2013 në vendin e 23-të në vitin 2016.
- Te *dinamizmi i biznesit* është rritur sasia dhe cilësia e furnizuesit lokal, gjendja e zhvillimit të grupimeve, kontrolli i shpërndarjes ndërkombëtare, sofistikimi i procesit të prodhimit dhe shtrirja e marketingut, kurse natyra e avantazhit konkurrues dhe gatishmëria për të deleguar autoritetin është e dobët.
- Pilari i *inovacionit* është zhvilluar për 48 shkallë, nga vendi i 99-të në vitin 2008, në vendin e 51-të në vitin 2016. Është përmirësuar cilësia e institucioneve kërkimore dhe shkencore, janë rritur shpenzimet e kompanisë për kërkim dhe zhvillim dhe bashkëpunimi kërkimor universitar-industri. Blerja e produkteve të teknologjisë së përparuar është rritur për 91 shkallë nga vendi i 106-të në vitin 2008 në vendin e 15-të në vitin 2016.

3.7 Analiza e Indeksit Global të Konkurrencës në Romani

Figura 13: Mesatarja e shtyllave të IGK-së në Romani



Burimi: WEF (2008-2017) dhe kalkulimet e autorit.


Figura 13 tregon mesataren e gjithë shtyllave të GCI-së në periudhën 2008 dhe 2017 në Romani. Ky shtet në vitin 2008 dhe 2017 te indeksi global i konkurrencës radhitet e 68-ta, mirëpo deri në vitin 2012 ka rënie, ku radhitet në vendin e 78-të si pasojë e krizës ekonomike globale e pastaj përmirësohet përsëri. Në vazhdim do ti tregojmë anët me te forta dhe te dobeta te cdo nenpilari:

- Pilari i *institucioneve* është ndikuar nga kjo krizë te të drejtat pronësore, mbrojtja e pronësisë intelektuale, devijimi i fondeve publike, besimi publik ndaj politikanëve, liria juridike, favorizimi në vendimet e zyrtarëve qeveritare, hedhjet e shpenzimeve qeveritare, barra e rregullave qeveritare, efikasiteti i kornizës ligjore në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, efikasiteti i kornizës ligjore në rregullat sfiduese, krimi i organizuar dhe besueshmëria e shërbimeve policore.
- Romania ka *infrastrukturë* të dobët, sidomos cilësia e infrastrukturës rrugore.
- *Stabiliteti makroekonomik* është përmirësuar për 38 shkallë, nga vendi i 76-të në vitin 2008, në vendin e 38-të në vitin 2017. Është përmirësuar balancimi i buxhetit qeveritar dhe është rritur shkalla e kursimit kombëtar, kurse borxhi i qeverisë ka rritje.
- Pilari i *shëndetsisë dhe arsimit fillor* është dobësuar te cilësia e arsimit fillor.

- Pilari i *arsimit të lartë dhe trajnimeve* është dobësuar te cilësia e sistemi arsimor, cilësia e shkollave të menaxhimit, qasja në internet në shkolla dhe shkalla e trajnimit të stafit. Disponueshmëria lokale e shërbimeve kërkimore dhe trajnuese është përkeqësuar deri në vitin 2012 e pastaj fillon të rregullohet.
- *Efikasiteti i tregut të punës* në vitin 2008 radhitet i 67-ti, në vitin 2013 i 117-ti, kurse në vitin 2017 i 92-ti. Kjo lëvizje vjen nga intensiteti i konkurrencës lokale, shtrirja e mbizotërimit të tregut, efektiviteti i politikës anti-monopole, shkalla totale e taksave, ndikimi i rregullave të biznesit në IHD, barra e procedurave doganore dhe shkalla e orientimit të klientit. Shkalla e tarifave të tregtisë është e ulët, kurse numri i procedurave dhe koha e nevojshme për të filluar biznes janë rritur.
- Te *efikasiteti i tregut të punës* bashkëpunimi punëtor-punëdhënës, fleksibiliteti i përcaktimit të pagës, praktikat e punësimit dhe pushimit nga puna, mbështetja në menaxhim profesional janë dobësuar pas krizës ekonomike globale deri kah viti 2012 dhe 2013 e pastaj kanë filluar të përmirësohen, kurse kapaciteti i vendit për të ruajtur dhe tërhequr talent është shumë i dobët.
- *Sofistikimi i tregut financiar* është dobësuar pas krizës globale, ka filluar të përmirësohet dhe 2 vitet e fundit përkeqësohet përsëri. Një lëvizje e tillë ndodh te financimi përmes tregut lokal të kapitalit lokal, lehtësia e hyrjes në kredi dhe riziko kapitali.
- Te *përgatitja teknologjike* Romania është ndikuar nga kriza globale te disponueshmëria e teknologjive të fundit dhe thithja e nivelit të fortë të teknologjisë. Te madhësia e tregut ky shtet ka përparësi konkurruese.
- Te *sofistikimi i biznesit* situata përkeqësohet pas krizës globale, fillon të rregullohet dhe pastaj fillon të dobësohet përsëri te sasia e furnizuesit lokal, gjendja e zhvillimit të grupimeve, kontrolli i shpërndarjes qeveritare, sofistikimi i procesit të prodhimit, shtrirja e marketingut dhe gatishmëria për të deleguar autoritetin.
- Lëvizje e ngjashme ndodh edhe te pilari i *inovacionit*, kryesisht te kapaciteti për inovacion, cilësia e institucioneve kërkimore dhe shkencore, shpenzimet e kompanisë në kërkim dhe zhvillim, bashkëpunimi kërkimor universitar-industri, blerja e produkteve të teknologjisë së përparuar dhe disponueshmëria e shkencëtarëve dhe inxhinierëve.

3.8 Analiza e Indeksit Global të Konkurrencës në Sërbi

Figura 14: Mesatarja e shtyllave të GCI-së në Serbi



Burimi: ËEF (2008-2017) dhe kalkulimet e autorit.

Figura 14 tregon mesataren e gjithë shtyllave të GCI-së në periudhën 2008 dhe 2017 në Serbi. Ky shtet gjatë kësaj periudhe 2008 është përmirësuar për 7 shkallë, nga vendi i 85-të në vitin 2008, ka ra në vendin e 101-të në vitin 2013 dhe ka arritur në vendin e 78-të në vitin 2017. Në vazhdim do ti tregojmë anët me te forta dhe te dobëta të cdo nenpilari:


- *Institucionet* fillimisht janë dobësuar e pastaj kanë filluar të ecin në drejtim më të mirë, por ky shtet në këtë pilar qëndron kryesisht dobët, duke filluar nga të drejtat pronësore, mbrojtja e pronësisë intelektuale, liria juridike, favorizimi në vendimet e zyrtarëve qeveritarë, barra e rregullave qeveritare, efikasiteti i kornizës ligjore në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, efikasiteti i kornizës ligjore në rregullat sfiduese, krimi i organizuar dhe forca e standardeve të auditimit dhe raportimit.
- *Infrastruktura* është zhvilluar gjatë periudhës së analizuar, me theks të veçantë ajo e transportit ajror, kurse infrastruktura rrugore është shumë e dobët.
- *Stabiliteti makroekonomik* është dobësuar pas krizës ekonomike globale të vitit 2008, deri në vitin 2013 e pastaj ka filluar të marr drejtim më të mirë. Balancimi i buxhetit qeveritar nga vendi i 54-të në vitin 2008 ka ra në vendin e 132-të në vitin

2013, kurse në vitin 2017 është përmirësuar dhe ka zënë vendin e 35-të. Inflacioni vazhdimisht ka qenë i keq menaxhuar deri në vitin 2014 dhe pastaj përmirësohet, shkalla e kursimit kombëtar është e ulët, ndërsa borxhi i qeverisë është rritur vazhdimisht.

- *Shëndetësia dhe arsimit fillor* kryesisht qëndron mirë, cilësia e arsimit fillor është përkeqësuar deri kah viti 2013 e pastaj rregullohet përsëri.
- Edhe te *arsimi i lartë dhe trajnimet* kemi një dobësim deri në vitin 2013 e pastaj rritet vlera e GCI-së. Një lëvizje e tillë ndodh te cilësia e sistemit arsimor, cilësia e arsimit të matematikës dhe shkencës, cilësia e shkollave të menaxhimit dhe disponueshmëria lokale e shërbimeve kërkimore dhe trajnuese.
- *Shkalla e trajnimit të stafit* kryesisht është shumë e dobët. Te efikasiteti i tregut të mallrave Serbia ka desavantazh konkurrues te intensiteti i konkurrencës lokale, shtrirja e mbizotërimit të tregut, efektiviteti i politikës anti-monople, shkalla e orientimit të klientit dhe sofistikimi i blerësit. Është rritur norma tatimore dhe kostot e politikës bujqësore, kurse ka ra numri i procedurave të nevojshme për të filluar biznes. Është rritur mbizotërimi i pronësisë së huaj dhe ndikimi i rregullave të biznesit në IDH.
- *Efikasiteti i tregut të punës* është përkeqësuar te bashkëpunimi punëtor-punëdhënës, fleksibiliteti i përcaktimit të pagës, praktikat e punësimit dhe pushimit nga puna dhe pagimi dhe produktiviteti. Mbështetja në menaxhim profesional është shumë e paktë dhe kapaciteti i vendit për të ruajtur dhe tërhequr talent është shumë i dobët.
- *Sofistikimi i tregut financiar* është dobësuar, me theks të veçantë gjatë viteve pas krizës ekonomike botërore. Ka ra mundësia e shërbimeve financiare, financimi përmes tregut lokal të kapitalit lokal dhe riziko kapitali.
- Te *përgatitja teknologjike* është rritur disponueshmëria e teknologjive të fundit, thithja e nivelit të fortë të teknologjisë është shumë e ulët, kurse IDH dhe transferimi teknologjive ka ra nga vendi i 14-të në vitin 2008, në vendin e 101-të në vitin 2017.
- Te *madhësia e tregut* Serbia ka përparësi konkurruese në krahasim me shtete e tjera të Evropës Juglindore që janë në tranzicion. Eksportet janë rritur nga vendi i 71-të në vitin 2013, në vendin e 29-të në vitin 2017.
- *Sofistikimi i biznesit* është ndikuar po ashtu nga kriza ekonomike globale, duke filluar nga sasia dhe cilësia e furnizuesit lokal, gjendja e zhvillimit të grupimeve, natyra e avantazhit konkurrues, gjerësia e zinxhirit të vlerës, kontrolli i shpërndarjes qeveritare, sofistikimi i procesit të prodhimit, shtrirja e marketingut e deri te gatishmëria për të deleguar autoritetin.
- Pilari i *inovacioneve* është përkeqësuar deri në vitin 2013 e pastaj ka nisur të përmirësohet. Kjo lëvizje ka ndodhur te kapaciteti për inovacion, cilësia e institucioneve kërkimore shkencore, shpenzimet e kompanive në kërkim dhe zhvillim, bashkëpunimi kërkimor universitar-industri, disponueshmëria e shkencëtarëve dhe inxhinierëve dhe patentat e shërbimeve.

3.9 Analiza e Indeksit Global të Konkurrencës në Slloveni

Figura 15: Mesatarja e shtyllave të GCI-së në Slloveni



Burimi: WEF (2008-2017) dhe kalkulimet e autorit.


Figura 15 tregon mesataren e gjithë shtyllave të GCI-së në periudhën 2008 dhe 2017 në Slloveni. Gjatë periudhës së vëzhguar Indeksi Global i konkurrencës në këtë shtet është dobësuar, në vitin 2008 ka qenë i ranguar në vendin e 42-të në botë, në vitin 2014 ka ra në vendin e 70-të, kurse në vitin 2017 është ngritur në vendin e 48-të. Kjo lëvizje ka ndodhur si pasojë e krizës ekonomike Botërore e vitit 2008 nga e cila Sllovenia është ndikuar shumë, por shpejt ka filluar të rimëkëmbet. Në vazhdim do ti tregojmë anët me te forta dhe te dobëta të cdo nenpilari:

- Te *institucionet* nga kjo krizë më tepër është ndikuar besimi publik ndaj politikanëve, liria juridike, favorizimi në vendime të zyrtarëve qeveritarë, hedhjet e shpenzimeve qeveritare, barra e rregullave qeveritare, efikasiteti i kornizës ligjore në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe efikasiteti i kornizës ligjore në rregullat sfiduese. Sllovenia ka përparësi të kostot e biznesit nga krimi dhe dhuna, kostot e biznesit nga terrorizmi dhe krimi i organizuar.
- Ky shtet ka *infrastrukturë* të mirë dhe vazhdimit ka përparësi konkurruese në këtë drejtim.

- *Stabiliteti makroekonomik* është prekur shumë nga kriza ekonomike, balancimi i buxhetit të qeverisë nga vendi i 62-të në vitin 2008 ka ra në vendin e 143 në vitin 2014 dhe është përmirësuar në vendin e 44-të në vitin 2017, kurse borxhi i qeverisë nga vendi i 37-të në vitin 2008 ka ra në vendin e 119-të në vitin 2015.
- Te pilari i *shëndetësisë dhe arsimit fillor* Sllovenia qëndron vazhdimisht në krye të listës së GCI-së. Te arsimi i lartë dhe trajnimet po ashtu qëndron vazhdimisht në top 30 shtetet e para, këtu vërehet që vetëm shkalla e trajnimit të stafit është dobësuar shumë deri në vitin 2013 e pastaj përmirësohet më shpejtësi.
- Te *efikasiteti i tregut të mallrave* nga kriza globale është ndikuar intensiteti i konkurrencës globale, shtrirja e mbizotërimit të tregut, efektiviteti i politikës anti-monopole, kostot e politikës bujqësore dhe sofistikimi i blerësit. Përhapja e barrierave tregtare, shkalla e tarifave të tregtisë dhe barra e procedurave doganore janë të mira, kurse mbizotërimi i pronësisë së huaj dhe ndikimi i rregullave të biznesit në IDH është i dobët.
- *Efikasiteti i tregut të punës* ka lëvizur nga vendi i 61-të në vitin 2008, në vendin e 106-të në vitin 2013, kurse në vitin 2017 rangohet në vendin e 82-të. Është dobësuar bashkëpunimi punëtor-punëdhënës, fleksibiliteti i përcaktimit të pagës, praktikat e punësimit dhe pushimit nga puna dhe pagimi dhe produktiviteti. Me krizën ekonomike ka filluar edhe ikja trurit, kurse pjesëmarrja e femrës në fuqinë punëtore është vazhdimisht e lartë.
- *Sofistikimi i tregut financiar* është prekur thellë nga kriza ekonomike, ka ra mundësia dhe disponueshmëria e shërbimeve financiare, financimi përmes tregut lokal të kapitalit lokal, riziko kapitali, qëndrueshmëria e bankave dhe lehtësia e hyrjes në kredi e cila nga vendi i 27-të në vitin 2008 ka ra në vendin e 140-të në vitin 2014.
- Te *përgatitja teknologjike* Sllovenia ka përparësi konkurrese, disponueshmëria e teknologjive të fundit dhe thithja e nivelit të fortë të teknologjisë është rritur vazhdimisht, po ashtu qëndron mirë edhe te adaptimi i TIK-ut.
- Te *madhësia e tregut* vërehet që madhësia e tregut të brendshëm është zvogëluar, kurse eksportet vazhdimisht janë shumë të larta.
- *Sofistikimi i biznesit* është pilar i cili po ashtu është ndikuar nga kriza globale, veçanërisht te sasia e furnizuesit lokal, gjendja e zhvillimit të grupimeve, gjerësia e zinxhirit të vlerës, kontrolli i shpërndarjes ndërkombëtare, sofistikimi i procesit të prodhimit dhe shtrirja e marketingut.
- Situata të ngjashme ka edhe të pilari i *inovacioneve*, sidomos te kapaciteti për inovacion, shpenzimet e kompanive për kërkim dhe zhvillim, bashkëpunimi kërkimor universitar-industri dhe blerja e produkteve dhe shërbimeve të teknologjisë së përparuar. Te patentat e shërbimeve dhe cilësia e institucioneve kërkimore shkencore Sllovenia vazhdimisht ka përparësi konkurrese.

3.10 Analiza e Indeksit Global të Konkurrencës në Shqipëri

Figura 16: Mesatarja e shtyllave të GCI-së në Shqipëri



Burimi: WEF (2008-2017) dhe kalkulimet e autorit.


Figura 15 tregon mesataren e gjithë shtyllave të GCI-së në periudhën 2008 dhe 2017 në Shqipëri. Në këtë shtet gjatë kësaj periudhë kemi përmirësim në indeksin global të konkurrencës për 33 shkallë, nga vendi i 108-të në vitin 2008, në vendin e 75-të në vitin 2017. Në vazhdim do ti tregojmë anët me te forta dhe te dobëta të cdo nenpilari:

- Te *institucionet* vërejmë që ky shtet ka probleme me të drejtat pronësore, mbrojtjen e pronësisë intelektuale, lirinë juridike, efikasitetin e kornizës ligjore në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe krimin e organizuar. Është përmirësuar në besimin publik ndaj politikanëve, hedhjet e shpenzimeve qeveritare dhe besueshmërinë e shërbimeve policore.
- *Infrastruktura* e përgjithshme është përmirësuar këtë periudhë, me theks të veçantë infrastruktura rrugore e cila ka lëvizur për 57 shkallë, nga vendi i 114-të në vitin 2008-të, në vendin e 57-të në vitin 2017.

- Te *stabiliteti makroekonomik* deficiti i qeverisë është rritur pas krizës ekonomike globale, por ka filluar të përmirësohet gradualisht, kurse borxhi i qeverisë është rritur vazhdimisht, sidomos vitet pas krizës ekonomike globale.
- Te pilari i *shëndetësisë dhe arsimit fillor* Shqipëria qëndron më mirë nga të gjitha pilaret tjera, aty vërejmë që jetëgjatësia në Shqipëri ka lëvizur për 30 shkallë, nga vendi i 69-të në vitin 2008, në vendin e 39-të në vitin 2017, po ashtu edhe cilësia e arsimit fillor është përmirësuar për 40 shkallë nga vendi i 64-të në vitin 2008, në vendin 24-të në vitin 2017.
- Te *arsimi i lartë dhe trajnimet* vërejmë që është rritur regjistrimi terciar, cilësia e sistemit arsimor, qasja në internet në shkolla dhe shkalla e trajnimit të stafit.
- Te pilari i *efikasitetit të tregut të mallrave* vërehet që intensiteti i konkurrencës lokale, shtrirja dhe mbizotërimi i tregut, efektiviteti i politikës anti-monopole është shumë i dobët, është ulur numri i procedurave dhe koha e nevojshme për të filluar biznes, kostot e politikës bujqësore janë ulur për 94 shkallë, nga vendi i 114-të në vitin 2007 në vendin e 20-të në vitin 2017 dhe ndikimi i rregullave të biznesit në IDH nga vendi i 116-të në vitin 2008 në vendin e 24-të në vitin 2017.
- Te *efikasiteti i tregut të punës* është përkeqësuar fleksibiliteti i përcaktimit të pagës, kapaciteti i vendit për të ruajtur dhe tërhequr talent, ndërsa qëndron mirë në bashkëpunimin punëtor-punëdhënës, praktikat e punësimit dhe pushimit nga puna dhe në pagimin dhe produktivitetin.
- Te *sofistikimi i tregut financiar* Shqipëria qëndron shumë dobët te financimi përmes tregut lokal të kapitalit lokal dhe kapitalit çka e zotërojnë firmat për rast rreziku, kurse është përmirësuar qëndrueshmëria e bankave, diponueshmëria e shërbimeve financiare dhe mundësia e shërbimeve financiare.
- Te *përgatitja teknologjike* është rritur thithja e niveli të fortë të teknologjisë, IHD dhe transferimi i teknologjisë është rritur për 63 shkallë, nga vendi i 97-të në vitin 2008, në vendin e 34-të në vitin 2017.
- *Madhësia e tregut të jashtëm dhe tregut të brendshëm* është kryesisht e vogël në Shqipëri, ndërsa PBB-JA ka rënie, në vitin 2013 radhitet e 69-ta, kurse në vitin 2017 e 107-ta.
- Te *sofistikimi i biznesit* është rritur dukshëm sasia dhe cilësia e furnizuesit lokal dhe shtrirja e marketingut, kurse qëndron shumë dobët në gjendjen e zhvillimi të grupimeve dhe gjerësinë e zinxhirit të vlerës.
- Te *pilari i inovacioneve* kapaciteti për inovacion është rritur për 88 shkallë, nga vendi i 134-të në vitin 2008, në vendin e 46-të në vitin 2017, blerja e produkteve të teknologjisë së përparuar për 94 shkallë, nga vendi i 119-të në vitin 2008 në vendin e 25-të në vitin 2017, po ashtu janë rritur shpenzimet e kompanive për kërkim dhe zhvillim dhe bashkëpunimi kërkimor universitar-industri, ndërsa cilësia e institucioneve kërkimore shkencore dhe disponueshmëria e shkencëtareve dhe inxhinierëve është e dobët.

4.KONKURENCA GLOBALE DHE RITJA EKONOMIKE

Figura 17: Indeksi global i konkurrencës dhe rritja e PBB-së në shtetet e Evropës Juglindore



Burimi: WEF 2017 dhe kalkulimet e autorit.

Nga figura më lartë e cila tregon pozitën e shteteve të Evropës Juglindore sipas Indeksit Global të Konkurrencës dhe rritjes së PBB-së në vitin 2017 mund të vërejmë që sa i përket Indeksit Global të Konkurrencës më dobët qëndron Bosnja dhe Hercegovina me vlerën e GCI-së 3.76, kurse më mirë është Sllovenia dhe Bullgaria. Rritja e PBB-së më e dobët është në Greqi me -2.2%, ndërsa më e lartë është në Shqipëri me 3.33%.

5.METODOLOGJIA

